



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria për Prokurim Publik

Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të subjektit në procedurë: Grup i OE **"IDEAL PARTNERS" SHPK, me seli në Glllogoc**, Autoriteti Kontraktues – Drejtoria për Prokurim Publik e Komunës së Vushtrrisë, pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit të kërkesës të subjektit në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 6 lidhur me pikën 10 paragrafi 10.1 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, me datën **13.10.2023**, merr këtë:

V E N D I M

- 1. Refuzohet si e pabazë** Kërkesa për rishqyrtimin lidhur me Njoftimin Letër për Tenderuesin e pasuksesshëm, të subjektit në procedurë: OE **"IDEAL PARTNERS" SHPK, me seli në Glllogoc, në procedurën e prokurimit me titull: "Rregullimi i shtratit të Lumit Silnica dhe Lumit Llap", Nr.Prokurimi: VU644-23-9129-5-1-1, Nr. i brendshëm: VU644-23-120-511.**
- 2. Vërtetohet si i bazuar** Njoftimi për Kontratë të dt. **01.09.2023**, i Autoritetit Kontraktues – Drejtorisë për Prokurim Publik.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria për Prokurim Publik (në tekstin e mëtejme A.K.) gjatë vlerësimit të pretendimeve ankimore të OE të lartpërmendur në Kërkesën për rishqyrtim, konstatoj se pretendimet e OE janë tërësisht të pabazuara, për faktin se Dosja e Tenderit është hartuar duke u bazuar në legjislacionin primar dhe sekondar të prokurimit publik, përmes së cilës janë krijuar kushtet dhe mundësitë për pjesëmarrje (ofertim) të barabartë për të gjithë OE të interesuar.

Në Kërkesën për rishqyrtim, Ankuesi konsideron se A.K. duke vendosur si në Njoftimin për Kontratë e dt. 01.09.2023, ka shkelur dispozitat e LPP-së, konkretisht: nenin 1, 7 dhe 69.

Ankuesi pretendon se:

Te kërkesa 4, OE duhet të posedojë mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për ekzekutimin e punëve. Pajisjet dhe mekanizmi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 7 të DT, pika 22: Ngjeshëse hidraulike për ngjeshjen e dheut që montohet në bager. Këtë pikë kërkoj që të largohet nga kërkesat e pajisjeve, sepse nuk është e nevojshme për realizimin e projektit.

Ky pretendim është plotësisht i pabazuar, pasi që Autoriteti Kontraktues, me rastin e përcaktimit të kërkesave për pajisje dhe mekanizëm të obligueshëm, e ka vlerësuar si nevojë të domosdoshme edhe pajisjen në fjalë, pasi që e njëjta nevojitet për ngjeshjen e dheut pranë shtratit të lumit minor, prandaj përdorimi i kësaj pajisje eviton rreziqet anësore për punëtorët, të cilët në mungesë të saj, i ekspozohen rrezikut të drejtpërdrejt nga rrjedha e lumit.

Nga sa u tha më lartë, e në përputhje me nenin 108/A pika 10 paragrafi 10.1 të LPP-së A.K. vlerëson se pretendimet ankimore të Ankuesit janë plotësisht të paargumentuara dhe për rrjedhojë të pa bazuara, andaj A.K. konstaton se nuk ka asnjë arsye të vendosë ndryshe nga ajo që është thënë si më lartë, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria për Prokurim Publik
K.R. nr. 120/2023 - datë 10.10.2023

Drejtoria për Prokurim Publik


Alban Tahiraj - Drejtor

Vendimi i dërgohet:

1. 1x Palës,
2. 1 x DPP-së, dhe
3. 1 x Arkivit (1 kopje)